



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr. 119 dt.29.03.1994

MBI
DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE PER MUAJIN SHKURT 1994

Në zbatim të Ligjit Nr.7710, dt.18.05.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror”, neni.7, pika.3b, V.K.M. Nr.622, dt.31.12.1993 “Për dhënie e ndihmës ekonomike”, Udhëzimit Nr.9, dt.23.02.1994 të Ministrisë së Punës, Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me dt.29.03.1994, pasi shqyrtoi dhe relacionin e paraqitur nga Seksioni i Mbrojtjes Shoqërore

VENDOSI

1. Të miratojë sqaruesin dhe formularin “Të dhëna mbi verifikimin e gjendjes reale në familje”.
2. Të realizohet brenda muajit Qershor 1994, verifikimi dhe shtresimi i të gjitha familjeve që përfitojnë Ndhmë Ekonomike.
3. Deri në përfundimin e këtij verifikimi të gjitha familjet do të trajtohen me Ndhmë Ekonomike sipas kufirit minimal të Udhëzimit Nr.9 të Ministrisë Punës.

4. Familjet që nga ky verifikim do të rezultojnë shumë të varfëra, në përputhje me fondet, tu jepet edhe diferenca e muajve gjatë të cilave u bë verifikimi.
5. Të verifikohen brënda muajit familjet e reja që paraqesin dokumentat për tu trajtuar me ndihmë ekonomike.
6. Të mos përfitojnë ndihmë ekonomike për muajin shkurt 100 familje, që nga verifikimi u konstatua se kishin makinë, dyqan, mirëqënie etj, sipas pasqyrës bashkangjitur që është pjesë e këtij projekt vendimi.
7. Të përfitojnë ndihmë ekonomike :
Për muajin Shkurt gjithsej 10.086 familje me një fond 26.3 milion lekë. Nga këto :

Me ndihmë të plotë 8.913 familje , 255 milion lekë
Me ndihmë të pjesëshme 1.173 familje , 760 mijë lekë
Për muajin Janar 1.174 familje me ndihmë të pjesëshme,
760 mijë lekë

Për muajin Dhjetor 126 familje , me një fond 327 mijë lekë

Të detajuar sipas pasqyrës bashkangjitur që është pjesë e këtij projekt vendimi.

8. Familjet që në muajin Janar janë trajtuar me 50% të Ndhmës Ekonomike, diferenca tu jepet bashkë me Marsin në përputhje kjo me rezultatet e verifikimit në 2000 familje që është duke u kryer sipas Urdhërit të Ministrisë Punës.
9. Nga rastet e veçanta :

Miratohen 31 familje të Janarit harruar nga administratorët(Njësia.1, 3 Njësia.3,3, Njësia.7, 25 familje) duke ju tërhequr vëmendjen për pakujdesi në punë (Njësisë.7).

- Kasem Nexhipi, 4 antarë, ti pezullohet ndihma për saktësim adrese.

- Qazim Gjuzi, 1 antarë, ti jepet ndihma ekonomike për muajin Nëntor 1993.
- Lulzim Kolës, 4 antarë, kërkesa nuk miratohet pezullohet.
- Fahri Mahmutllari, 4 antarë, ti pezullohet ndihma për plotësim verifikimi.
- Bashkim Meta, 4 antarë, tu pezullohet ndihma.
- Idriz Idrizi, 3 antarë, për një sqarim më të hollësishëm.
- Shpëtim Hysa, 4 antarë me administratoren.
- Bashkim Sula, 5 antarë.

10. Personat që kanë përfituar ndihmë ekonomike dhe njëkohësisht vërtetohet që kanë makinë, dyqan, troje, shtëpi të dhëna me qira kryejnë investime, janë të punësuar në sektorë shtetëror ose privat, nuk kanë dhënë adresë të saktë banimi si dhe çdo veprim tjetër i qëllimshëm për të përfituar ndihmë ekonomike në mënyrë të pa drejtë do të gjobiten deri në 3 – fishin e shumës së përfituar.

11. Për zbatimin dhe ndjekjen e këtij vendimi ngarkohen Seksioni i Mbrojtjes Shoqërore dhe administratorët e lagjeve, (Seksioni i Financës, pagatorët, arshivistët e njësive administrative).

KRYETARI

BESNIK PETRELA